



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 233/2019
Datë: 6 nëntor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK) konform nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, nenit 12 paragrafi 2 dhe 3, si dhe nenit 18 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 226-të, të mbajtur me datë 6 nëntor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Znj. Anita Krasniqi-Prenaj, gjyqtare e Gjykatës Themelore në Prishtinë/anëtare e KGJK-së, PEZULLOHET nga detyra e gjyqtares gjatë shërbimit në Këshill si kryetare e Komisionit për Çështje Normative.
- II. Gjatë kësaj periudhe znj. Krasniqi-Prenaj, do të pranojë pagën e përcaktuar sipas nenit 18 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.
- III. Znj. Krasniqi-Prenaj, nuk do të humbas statusin e saj si gjyqtare dhe ka të drejtë t'i kthehet shërbimit si gjyqtare në gjykatën në të cilën ka shërbyer para emërimit në pozitën sipas paragrafit 1 të dispozitivit të këtij vendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi nga data 6 nëntor 2019.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 6 nëntor 2019, ka caktuar gjyqtaren/anëtare e KGJK-së Anita Prenaj-Krasniqi, kryetare të Komisionit për Çështje Normative.

KGJK konform nenit 12 paragrafi 2 të Ligji Nr. 06/L- 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ka pezulluar znj. Krasniqi-Prenaj, nga detyra e gjyqtares gjatë shërbimit në Këshill si kryetare e Komisionit për Çështje Normative, e cila gjatë kësaj periudhe do të pranojë pagën ekuivalente të gjyqtarit të Gjykatës Supreme.

Andaj, KGJK, bazuar në dispozitat përkatëse të Ligji Nr. 06/L- 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Skender ÇOÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet

- *Znj. Anita Krasniqi –Prenaj;*
- *Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së, si dhe*
- *Arkivës.*